



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK

**VENDIM**

**Nr. 10 datë 26.2.2021**

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË VLERËSIMEVE DHE  
PARASHIKIMEVE AFATMESME TË TË ARDHURAVE TË BASHKISË SË  
SHKODRËS PËR VITET 2022 - 2024**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 26.2.2021, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në neneve 8, 9, neneve 34-37, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", kreu III, dhe nenit 34, pika 1-3, te Ligjit nr.68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore"; Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar; Ligjit nr. 9632, dt. 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar; Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar ; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore".,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë raportin e vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave të bashkisë së Shkodrës për vitet 2022 - 2024, sipas dokumentit pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Shkodër.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.



Sekretari i Këshillit Bashkiak



Denis Lesha

Miratuar me 26 vota

Vota Pro 26

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 2.3.2021

**RAPORTI I VLERËSIMEVE DHE PARASHIKIMEVE AFATMESME  
TË TË ARDHURAVE TË VETA  
BASHKIA SHKODËR PËR VITET 2022-2024.**



## **Përbajtja**

A.	Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave	3
A.1	Të ardhurat nga Taksat Vendore	13
A.2	Të ardhurat nga Taksat e Ndara	15
A.3	Te ardhurat nga Tarifat Vendore	16
A.4	Te ardhura të tjera	19
B.	Metodologjia e përdorur për parashikimet afatmesme të të ardhurave	22
C.	Analiza e efekteve të politikave të reja fiskale ose të ndryshimit të atyre ekzistuese.	34
D.	Analiza e risqeve dhe masat për përballimin e tyre	36

## A. Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave

Të ardhurat e veta përfshijnë të gjitha burimet e të ardhurave, me përashtim të transfertave nga burimet qendrore. Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Llogaritja e të ardhurave mbështetet në:

1. Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", te ndryshuar;
2. Ligjin nr.9920 datë 26.05.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar;
3. Vendimin e Këshillit të Bashkisë Shkodër nr 1 date 22.01.2016 "Për miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Shkodër", të ndryshuar;
4. Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".

Vlerësimi dhe parashikimi i te ardhurave nga taksat/tarifat vendore/të ardhura të tjera mbështetet në paketën fiskale të Bashkisë Shkodër, të përditësuar, e cila përcakton llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkatgorizimet, këstet e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, efektet e lehtësive, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimore.

Paketa fiskale përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre.

Në mënyrë të hollësishme, përveç strukturimit, detajon çdo lloj takse të administruar nga organet vendore të administritimit, përcakton qartë edhe administrimin e saj duke filluar me mënyrën e llogaritjes, personat përgjegjës të pagimit të taksës dhe ato të mbledhjes së saj.

Në përditësimin e paketës fiskale të Bashkisë së Shkodrës ndër vite janë përfshirë përfaqësues të biznesit të madh dhe të vogël, banorë të njësive administrative, përfaqësues të komunitetit sipas interesit dhe përfaqësues të partive politike e këshilltarë, me diskutime publike të organizuara në çdo njësi administrative dhe në qytet. Ndryshimet dhe përditësimet e paketës fiskale janë bërë pas takimeve konsultative gjithpërfshirëse me bashkëqytetarë, banorë, përfaqësues të grupeve të interesit, pas diskutimeve dhe propozimeve për përmirësim.

Paketa fiskale e bashkisë Shkodër, pasqyron disa politika të rëndësishme për uljen e disa niveleve ligjore/kufi, etj.sipas kompetencave ligjore, si më poshtë:

### Politikat incentivuese në taksa:

- Ulje e taksës së ndërtesës për qëllime banimi në Nj.A. në 30% nga refenca ligjore.
- Taksë banese zero për pensionistët dhe përfituesit e ndihmës ekonomike.
- Ulje e taksës së ndërtesës për qëllime biznesi në Nj.A. në 30% nga refenca ligjore.
- Ulje në nivelin maksimal të lejuar prej 30% të taksës së tokës bujqësore.
- Ulje deri në nivelin minimal ligjor për taksën e ndikimit në infrastrukturë.

### **Politikat incentivuese dhe uljet nën nivelet e kostos së shërbimit të llogaritur:**

- Tarifa zero për shërbimin e gjelbërimit për zonat rurale
- Tarifa minimale deri në zero për shërbimin e ndriçimit publik në zonat rurale
- Tarifa zero për familjet me ndihmë ekonomike.
- Tarifa të reduktuara 50% sipas kritereve për pensionistë, invalidë, etj.
- Tarifa 0 (zero) për fermerët që janë regjistruar me NIPT nga Drejtoria Tatimore
- Tarifa të ulëta pastrimi, dhe pa tarifa të tjera për ambulantët

Për vitin 2020, në kuadër të fatkeqësisë natyrore COVID-19, u ndërmor një lehtësi për të gjitha kategoritë e taksapaguesve në Bashkinë Shkodër.

Bashkia Shkodër, tashmë, ka ndërtuar një sistem të integruar me një ndalesë për regjistrimin dhe shërbimin për taksapaguesit biznes dhe familje të shpërndarë në të gjithë territorin e Bashkisë. Janë ndërtuar bazat e të dhënave gjithnjë e më të sakta të taksapaguesve, sipas kategorive, biznes dhe familje, dhe nga viti në vit janë konsoliduar dhe azhornuar të dhënat për bazën e taksueshme dhe nivelin e aplikueshëm të tarifave sipas llojit.

Bashkia Shkodër ka kërkuar lidhjen e të dhënave për pasuritë e paluajtshme që disponon ASHK (Agjensia Shtetërore e Kadastrës) me sistemin e Kadastrës Fiskale që administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.


Sipas ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nen 35/2, bashkitë e ushtrojnë të drejtën e vendosjes së nivelit të taksës, mënyrën e llogaritjes së saj, si dhe mbledhjen e administrimin e tyre brenda kufijve e sipas kritereve të përcaktuara me ligj.

Të ardhurat nga burimet e veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat vendore, të ardhura nga taksat e ndara, nga tarifat vendore, dhe të ardhura të tjera.

Të ardhurat e veta	mijë lekë					
	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
<b>Të ardhurat e veta</b>	<b>682,069</b>	<b>659,778</b>	<b>822,317</b>	<b>837,657</b>	<b>852,703</b>	<b>853,202</b>
Të ardhura nga taksat vendore	<b>268,810</b>	<b>233,917</b>	<b>373,082</b>	<b>375,874</b>	<b>384,417</b>	<b>384,916</b>
Të ardhura nga taksat e ndara	<b>94,614</b>	<b>126,722</b>	<b>105,949</b>	<b>115,444</b>	<b>119,144</b>	<b>119,144</b>
Të ardhura nga tarifat vendore	<b>287,611</b>	<b>274,154</b>	<b>316,584</b>	<b>319,618</b>	<b>322,481</b>	<b>322,481</b>
Të ardhura të tjera +grante nderkombetare+donacione	<b>31,034</b>	<b>24,985</b>	<b>26,702</b>	<b>26,721</b>	<b>26,661</b>	<b>26,661</b>
Grante nderkombetare me me sistem të pjesshëm thesari	<b>7,596</b>	<b>10,815</b>	<b>55,103</b>	<b>10,815</b>		
<b>Të ardhurat total</b>	<b>689,665</b>	<b>670,593</b>	<b>877,420</b>	<b>848,472</b>	<b>852,703</b>	<b>853,202</b>

Të ardhurat e veta	mijë lekë					
	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
<b>Të ardhurat e veta</b>	<b>682,069</b>	<b>659,778</b>	<b>822,317</b>	<b>837,657</b>	<b>852,703</b>	<b>853,202</b>
Të ardhura nga taksat vendore	<b>268,810</b>	<b>233,917</b>	<b>373,082</b>	<b>375,874</b>	<b>384,417</b>	<b>384,916</b>
Të ardhura nga taksat e ndara	<b>94,614</b>	<b>126,722</b>	<b>105,949</b>	<b>115,444</b>	<b>119,144</b>	<b>119,144</b>
Të ardhura nga tarifat vendore	<b>287,611</b>	<b>274,154</b>	<b>316,584</b>	<b>319,618</b>	<b>322,481</b>	<b>322,481</b>
Të ardhura të tjera +grante nderkombetare+donacione	<b>31,034</b>	<b>24,985</b>	<b>26,702</b>	<b>26,721</b>	<b>26,661</b>	<b>26,661</b>
Grante nderkombetare me me sistem të pjesshëm thesari	<b>7,596</b>	<b>10,815</b>	<b>55,103</b>	<b>10,815</b>		
<b>Të ardhurat total</b>	<b>689,665</b>	<b>670,593</b>	<b>877,420</b>	<b>848,472</b>	<b>852,703</b>	<b>853,202</b>

### Pesha e të ardhurave të veta sipas klasifikimit ekonomik 2022-2024



Të ardhurat e veta, qe mblidhen nga administrata e Bashkisë në vitet 2022-2024 parashikohen me një rritje mesatare prej 1.2 %.

Të ardhurat nga taksat vendore në vitet 2022-2024 parashikohen me një rritje mesatare prej 1.2 %.


Të ardhurat nga taksat e ndara në vitet 2022-2024 parashikohen me një rritje mesatare prej 4.1 %.

Të ardhurat nga tarifat vendore në vitet 2022-2024 parashikohen me një rritje mesatare prej 0.6 %.

Të ardhurat e tjera në vitet 2022-2024 janë në varësi të marrëveshjeve për donacione dhe aplikimeve të ndryshme për përfitime të granteve ndërkombëtare.

Kategoritë e taksave dhe tarifave qe ndikojnë më shumë në planin e të ardhurave nga burimet e veta për vitet 2022-2024 janë kryesisht taksa e pasurisë së paluajtshme që zë rrëth 22%, taksa e ndikimit në infrastrukturë që zë rrëth 18%, tarifa për pastrimin zë rrëth 20%, taksa e qarkullimit të mjeteve të përdorura zë rrëth 10%, tarifa e ndriçimit publik që zë rrëth 5%, tarifa të tjera ku përfshihen tarifat nga institucionet kulturore dhe tarifa administrative zëzë rrëth 10%. Këto zëra kryesorë mbulojnë rrëth 87% të planit të të ardhurave të Bashkisë Shkodër.

## Pesha e çdo takse dhe tarife në parashikimin e të ardhurave



Planifikimi i tē ardhurave tē veta përvitet 2022-2024 i kategorizuar sipas klasifikimit ekonomik ligjor paraqitet si më poshtë:

*në mijë lekë*

LLOJET E TĒ ARDHURAVE	Realizimi 2019	Realizimi 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
TĒ ARDHURAT E VETA	682,069	659,778	822,317	837,657	852,703	853,202
TĒ ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE	268,810	233,917	373,082	375,584	384,417	384,916
Tē ardhura nga taksa mbi fitimin për biznesin e vogël	6,991	9,280	7,650	7,800	7,800	7,800
Tē ardhura nga taksa mbi Biznesin e vogel (e prapambetur)	13	143	50	50	50	50
Tē ardhura nga taksa mbi pasurinë e palaujishme	160,311	135,534	179,343	181,158	183,516	183,966
Tē ardhura nga taksa mbi ndërtesa	142,135	117,505	144,500	146,000	148,230	148,230
Ndërtesa banimi	63,515	53,623	65,440	66,374	68,365	68,365
Ndërtesa i ëjera	78,620	63,882	79,060	79,626	79,865	79,865
Tē ardhura nga taksa mbi tokët bujqësore	4,446	4,698	21,736	21,736	21,736	21,736
Tē ardhura nga taksa mbi trallin	13,730	13,332	13,107	13,422	13,550	14,000
Tē ardhura nga taksa e fjetjes në hotel	19,756	7,380	15,000	20,000	20,000	20,000
Tē ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	69,003	69,673	155,044	150,076	156,051	156,100
Tē ardhura nga taksa e tabelës	12,736	11,906	15,995	16,500	17,000	17,000
TĒ ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	94,614	126,722	105,949	115,444	119,144	119,144
Tē ardhura nga taksa vjetore per qarkullimin e mjeteve të përdorura	78,861	85,720	80,100	82,503	84,978	84,978



BASHKIA  
SHKODËR

Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësës për pasuritë e paluajtshme	<b>15,721</b>	<b>12,444</b>	<b>14,560</b>	<b>15,120</b>	<b>15,722</b>	<b>15,722</b>
Të ardhura nga taksa e rentës minerare	<b>32</b>	<b>13</b>	<b>35</b>	<b>35</b>	<b>35</b>	<b>35</b>
Të ardhura nga tatuimi mbi të ardhurat personale		<b>28,545</b>	<b>11,254</b>	<b>17,786</b>	<b>18,409</b>	<b>18,409</b>
<b>TE ARDHURA NGA TARIFAT VENDORE</b>	<b>287,611</b>	<b>274,154</b>	<b>316,584</b>	<b>319,908</b>	<b>322,481</b>	<b>322,481</b>
Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave	<b>166,913</b>	<b>149,117</b>	<b>169,711</b>	<b>169,935</b>	<b>170,462</b>	<b>170,462</b>
Të ardhura nga tarifë pastrimi nga Familje	<b>71,035</b>	<b>72,661</b>	<b>73,699</b>	<b>73,900</b>	<b>73,900</b>	<b>73,900</b>
Të ardhura nga tarifë pastrimi nga Institucionë	<b>411</b>	<b>715</b>	<b>512</b>	<b>512</b>	<b>512</b>	<b>512</b>
Të ardhura nga tarifë pastrimi nga Biznesi	<b>95,447</b>	<b>75,741</b>	<b>95,500</b>	<b>95,523</b>	<b>96,050</b>	<b>96,050</b>
Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik	<b>33,306</b>	<b>30,902</b>	<b>39,767</b>	<b>40,161</b>	<b>40,559</b>	<b>40,559</b>
Të ardhura nga tarifë për ndriçimin publik nga Familje	<b>19,059</b>	<b>20,911</b>	<b>23,998</b>	<b>24,119</b>	<b>24,239</b>	<b>24,239</b>
Të ardhura nga tarifë ndriçimi publik nga Institucionë	<b>130</b>	<b>148</b>	<b>125</b>	<b>125</b>	<b>125</b>	<b>125</b>
Të ardhura nga tarifë ndriçimi publik nga Biznesi	<b>14,117</b>	<b>9,842</b>	<b>15,644</b>	<b>15,917</b>	<b>16,195</b>	<b>16,195</b>
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin	<b>22,272</b>	<b>19,819</b>	<b>22,972</b>	<b>23,303</b>	<b>23,573</b>	<b>23,573</b>
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin nga Familje	<b>9,012</b>	<b>9,665</b>	<b>9,602</b>	<b>9,669</b>	<b>9,670</b>	<b>9,670</b>
Të ardhura nga tarifë gjelbrimi nga Institucionë	<b>133</b>	<b>147</b>	<b>160</b>	<b>160</b>	<b>160</b>	<b>160</b>
Të ardhura nga tarifë gjelbrimi nga Biznesi	<b>13,127</b>	<b>10,007</b>	<b>13,210</b>	<b>13,474</b>	<b>13,743</b>	<b>13,743</b>
Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë	<b>65,120</b>	<b>74,316</b>	<b>84,134</b>	<b>86,509</b>	<b>87,887</b>	<b>87,887</b>
Nga tarifa shërbimie administrative, kontroll zhvillim territorit, AMTP, ej.	<b>3,482</b>	<b>3,146</b>	<b>3,604</b>	<b>3,604</b>	<b>3,608</b>	<b>3,608</b>
Nga tarifa për vulosje veterinare të bagëtive të therura	<b>219</b>	<b>797</b>	<b>848</b>	<b>910</b>	<b>970</b>	<b>970</b>

Nga tarifat e licënsimit të veprimtarive të transportit	764	909	1,050	1,100	1,100	1,100
Nga tarifat përmjet e licënsuara, dhe për vendparkime publike	4,787	3,499	4,508	4,917	5,101	5,101
Nga tarifë për dhëni licensa për tregimin e naftës bruto dhe nënproukteve ië saj	1,000	9,478	5,000	5,000	5,000	5,000
Nga tarifat në sektorin e pyjeve dhe kullotave.	99	123	580	580	580	580
Nga tarifat e shërbimeve që kryen struktura e MKZ	1,535	1,314	660	760	860	860
Nga tarifa për zërien e hapësirave publike	35,469	45,350	45,000	46,000	46,000	46,000
Nga linjat ajrore dhe nëntokësore (Telefoni, Energi, TV Kabllor, Internet)	0	-	500	1,000	1,200	1,200
Nga dokumentat për tender, ankand ej.	16	-	12	13	13	13
Nga tarifat të institucioneve të arsimt, kultures, sportit, etj	17,749	9,750	22,372	22,625	23,455	23,455
Biblioteka "Marin Barleti"	21	3	15	20	50	50
Muzetumet	2,407	590	2,500	2,500	2,500	2,500
Teatri "Migjeni"	1,105	32	1,800	2,000	2,200	2,200
Qendra Kulturore e fëmijëve	0	-	177	185	185	185
Pallati sportiv "Qazim Dervishi"	630	152	650	650	650	650
Nga stadiumi "Loro Borici"		-	800	800	800	800
Qendra Komunitare	0	10	0	10	10	10
Nga mensat (konviktet)	103	63	30	60	60	60
Nga kopshitet	8,652	5,927	11,100	11,100	11,500	11,500
Nga cerdhet	4,831	2,973	5,300	5,300	5,500	5,500
<b>TË ARDHHURA TË TJERA</b>	<b>31,034</b>	<b>24,986</b>	<b>26,702</b>	<b>26,721</b>	<b>26,661</b>	<b>26,661</b>


Të ardhura nga kundravajtjet administrative (Gjobat)	21,914	12,100	20,000	20,000	20,000
Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të Bashkisë	3,675	1,804	2,543	2,508	3,190
Të ardhura nga sekuestrime dhe zhëmtimë	1,108	5,011	3,060	3,091	3,100
Të ardhura nga shitja e mallrave dhe e sherbimeve	1,261	-			0
Të ardhura nga aktivëve të qëndrueshme të trupëzuara	0	-	0	0	0
Të ardhura nga privatizimi	0	-	0	0	0
Të ardhura te tjera si agjent tatimor për taksen e pulles	320	247	341	364	371
Të ardhura nga garanci financiare	0	-			
TË ARDHURA NGA DONACIONET	1,330	5,129	0	0	0
Grante nga ndihma nderkombetare me sistem të plotë thesari	1,426	694	758	758	0
PARK4SUMP	1,426	694	758	758	0
Grante nga ndihma nderkombetare me sistem të pjeshëm thesari	7,596	10,815	55,103	10,815	0
IADSA I	1,001				
100 DRITAT	6,595				
EFICIENCA E ENERGISE BASHKI TE ZGUJARA			33,474		
IADSA II		10,815	21,629	10,815	
<b>TË ARDHURA TË VETA TOTAL</b>	<b>689,665</b>	<b>670,593</b>	<b>877,420</b>	<b>848,472</b>	<b>852,703</b>
					<b>853,202</b>

Të ardhurat nga burimet e veta vendore sipas Njësive Administrative

Pesha kryesore në realizimin e të ardhurave i ngarkohet Njësisë Administrative Shkodër, ose 71% të planit total të të ardhurave.

Planifikimi i të ardhurave për vitet 2022-2024 sipas Njësive Administrative / mijë Lekë											Njësi Administrative të tjera							
Viti	Totali	Njësta Administrative Qender					Njësi Administrative të tjera											
		Shuma	Lagje hr. 1	Lagje nr. 2	Lagje nr. 3	Lagje nr. 4	Lagje nr. 5	Shuma	Pult	Shosh	Shalë	Postribë	Guri i Zi	Bërdicë	Velipojë	Dajc	Ana e Malit	Rethina
Plan 2022	848,472	606,029	143,554	126,427	119,730	130,897	85,420	242,443	1,824	1,471	2,390	11,932	19,408	22,146	113,258	16,583	10,565	42,866
Plan 2023	852,703	604,650	143,227	126,140	119,457	130,600	85,226	248,053	1,866	1,491	2,461	12,129	19,694	22,544	116,636	16,827	10,719	43,686
Plan 2024	853,202	605,004	143,311	126,214	119,527	130,676	85,276	248,198	1,867	1,492	2,462	12,136	19,706	22,557	116,704	16,837	10,725	43,712

## Shpërndarja e të ardhurave sipas Njësive Administrative



## A.1 Të ardhurat nga Taksat Vendore


Ligji nr 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", me ndryshimet përkatëse, përbën ligjin bazë i cili përcakton rregullat për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të njësive të qeverisjes vendore në drejtim të taksave vendore, mbledhjes dhe administrimit e tyre.

Për vitet 2022-2024 parashikohet që të ardhurat nga taksat vendore përbëjnë rreth 45% të ardhurave nga burimet e veta të bashkisë.

LLOJET E TË ARDHURAVE	në 000/Lekë	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
<b>TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE</b>		<b>375,584</b>	<b>384,417</b>	<b>384,916</b>
Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël	7,800	7,800	7,800	
Të ardhura nga taksa mbi Biznesin e vogel (e prapambetur)	50	50	50	
Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme	181,158	183,516	183,966	
Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel	20,000	20,000	20,000	
Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	150,076	156,051	156,100	
Të ardhura nga taksa e tabelës	16,500	17,000	17,000	

Pjesë e rëndësishme në këtë kategori të taksave vendore janë të ardhurat nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme, e cila zë mbi 48% te totalit të ardhurave nga taksat vendore, dhe më pas vijnë të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja me 40%, taksa e tabelës dhe taksa e fjetjes në hotel me 5%.

**Të ardhura nga taksat vendore**



## **Të ardhura nga Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël**

Tatimi i thjeshtuar për biznesin e vogël administrohet nga Drejtoria Rajonale Tatimore, e cila në rolin e agjentit tatimor mban një komision prej 1% të vlerës së grumbulluar nga bizneset e vogla, ndërsa 99% kalon në favor të bashkisë Shkodër.

## **Të ardhura nga Taksa mbi pasurinë e paluajtshme**

Këto të ardhura përfshijnë te ardhurat nga :

- Taksa mbi ndërtesat (mbi ndërtesa banimi dhe ndërtesa biznesi)
- Taksa mbi tokën bujqësore
- Taksa mbi truallin

Parashikimi për vitet 2022-2024 bazohet te zgjerimi i bazës së taksapaguesve nëpërmjet:

- Saktësimit dhe vlerësimit të drejtë të sipërfaqeve nëpërmjet grupeve të punës të ngritura për këtë qëllim,
- Mbështetja nga agjentë tatimore,
- Ndarjes në këste të pagesave për familjarët,
- Shtrirje e mëtejshme e bazës taksapaguese, falë politikave fiskale lehtësuese dhe incentivave të ndërmarra, rivlerësimit të gjendjes faktike, përmirësimit të shërbimit dhe marrëdhënieς me taksapaguesin, si dhe bashkëpunimit të pritshëm me institucionin Agjencia e Kadastrës Shtetërore.

## **Të ardhura nga Taksa e fjetjes në hotel**

Planifikimi i të ardhurave me një rritje prej 2% në vit eshtë bërë ju referuar kapacitetit aktual dhe parashakimit të zgjerimit të tij, rritjes së numrit të njësive, si dhe shtrirjen periudhave të sezoneve turistike për ushtrimin e aktivitetit, duke shpresuar në përfundimin e pandemisë globale COVID-19.

## **Të ardhura nga Taksa e ndikimit në infrastrukturë**

Bashkia Shkoder, planin e të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastructure e ka bazuar:

- Bazuar në ligjin 9632, taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja eshtë përllogaritur duke marrë për bazë parashikimin e lejeve për ndërtime të reja në përputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor, miratuar me VKB nr.: 27, datë 20.04.2017 “Për miratimin e planit të zhvillimit të territorit dhe rregulloren e zbatimit të planit të përgjithshëm vendor të Bashkisë Shkodër” dhe me vendimin e KKT nr.5 date 16.10.2017 “Per miratimin e planit te per gjithshem vendor si dhe ne nismat Publike për hartim e PDV-ve, sipas Planit të Përgjithshëm Vendor, në disa njësi strukturore.

Kjo në mbështetje të ligjit nr.107/2014 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, VKM nr. 686 datë 22.11.2017 “Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër, si dhe në interesin public;

- Shlyerjen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastructure të objekteve të legalizuara për objektet në process legalizimi, si dhe detyrime tatimore të

pambledhura në kohë, prej më pak se 18 muaj nga afati i caktuar në legjislacionin në fuqi për pagesën e taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me ligjin. nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".

Realizimi i ardhurave nga kjo taksë lidhet dhe bazohet në zbatimin e masave shtrënguese, bllokimin e shërbimit të debitorëve nga bashkia Shkodër, si dhe në mbështetjen nga Agjencia e Kadastres Shteterore.

### Të ardhura nga Taksë e Tabelës

Parashikimi në rritje prej 1% i të ardhurave bazohet në rritjen e njësive takapaguese e në evidentimin e kapaciteteve të reja, si dhe në shtrirjen e mëtejshme të bazës taksapaguese dhe kërkesën në rritje për vendosje tabela reklamimi në akse kryesore rrugore.

#### A.2 Të ardhurat nga Taksat e Ndara

LLOJET E TË ARDHURAVE në 000/Lekë	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
<b>TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA</b>	<b>115,444</b>	<b>119,144</b>	<b>119,144</b>
Të ardhura nga taksa vjetore per qarkullimin e mjeteve të përdorura	82,503	84,978	84,978
Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	15,120	15,722	15,722
Të ardhura nga taksa e rentës minerare	35	35	35
Të ardhura nga tatimi mbi te ardhurat personale	17,786	18,409	18,409

Në përputhje me ligjin.nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".të ardhurat nga taksat e ndara, zënë 14% të totalit të të ardhurave të veta të Bashkisë Shkodër.

#### Të ardhura nga Taksë e regjistrimit të mjeteve të përdorura

Planifikimi i të ardhurave bëhet referuar numrit të automjeteve si dhe në eksperiencën e viteve të kaluara për nivelet e arkëtimeve nga Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor . Bashkia Shkodër përfiton 28 % të ardhura nga kjo taksë, e cila transferohet çdo muaj nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor.

Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme Planifikimi bëhet nga të dhenat e agjentit tatimorsi dhe bazuar në eksperiencën e vitevetëkaluarareferuarnumrittëprocedurave të tjetërsimit të pronës të kryera nga Agjencia Shteterore e Kadastrës ish-Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

#### Të ardhura nga Taksë e Rentës minerare

Planifikimi i të ardhurave i referohet realizimit të të ardhurave ndër vite.

#### Të ardhura nga tatimi mbi të ardhurat personale

Planifikimi i të ardhurave i është referuar të dhënave statistikore për të punësuarit në territorin e Bashkisë Shkodër, si dhe raporteve vjetore të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, të publikuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Detyrimi ligjor për këtë taksë të ndarë ka filluar në vitin 2018, por nuk është përmbrushur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për 2 vite rresht.

Vetem në vitin 2020, u transferua një shumë në favor të Bashkisë Shkodër në muajin Tetor 2020. Mbeten pa u transferuar shumat për vitet 2018 dhe 2019.

Parashikimi është bërë me rezerva, duke mos patur shifra të sakta zyrtare të sjella nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve.

### A.3 Te ardhurat nga Tarifat Vendore

Referuar ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nen 35/5, bashkitë krijojnë të ardhura nga tarifat vendore për: shërbimet publike që ato ofrojnë; dhënien e licencave, të lejeve, autorizimeve dhe për lëshimin e dokumenteve të tjera, për të cilat ato kanë autoritet të plotë, me përashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe me ligj. Gjithashtu bashkitë mund të krijojnë të ardhura nga veprimtaritë e tyre kulturore, sportive, dhe të tjera, të përcaktuara me ligj.


Bashkitë vendosin vetë për nivelin, mënyrën e mbledhjes dhe të administrimit të tarifave vendore, në përputhje me politikat dhe parimet e përgjithshme kombëtare të përcaktuara në ligjet në fuqi.

Për vitin 2022-2024 të ardhurat e parashikuara nga tarifat përbëjnë rreth 38% të të ardhurave të veta.

LLOJET E TË ARDHURAVE në 000/Lekë	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
<b>TE ARDHURA NGA TARIFAT VENDORE</b>	<b>319,908</b>	<b>322,481</b>	<b>322,481</b>
Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave	169,935	170,462	170,462
Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik	40,161	40,559	40,559
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin	23,303	23,573	23,573
Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë	86,509	87,887	87,887

Peshën më të madhe në kategorinë e të ardhurave nga tarifat vendore e zëne të ardhurat nga tarifat për ofrimin e shërbimeve publike të pastrimit e largimit të mbeturinave me 53% të totalit të tarifave, duke qenë edhe një nga aktivitetet kryesore në funksionin e shërbimeve publike, të gjelbrimit me 7%, të ndriçimit publik me 13%, të shërbimit administrativ të bashkisë me 27 %, ku bëjnë pjesë tarifa për zënien e hapësirës publike, tarifa të institucioneve të arsimit, kultures, sportit, etj

### Raporti i tarifave vendore mbi totalin e të ardhurave të veta



#### **Të ardhura nga tarifa e pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit.**

Parashikimi në rritje prej 0.3% i të ardhurave nga tarifat për pastrimin, ndriçimin dhe gjelbërimin, bazohet tek kapaciteti aktual dhe në rritjen e njësive takapaguese e në evidentimin e kapaciteteve të reja, si dhe në shtrirjen e mëtejshme të bazës taksapaguese falë politikave fiskale lehtësuese, përmirësimit te shërbimit dhe marrëdhënies me taksapaguesin, fokusimit në zona me kapacitete të pashfrytëzuara, si dhe sensibilizimin dhe trajtimin e biznesit si partner në dhënien e shërbimeve për komunitetin.

#### **Të ardhura nga tarifa për shërbimet administrative**

Nga tarifa për shërbimet administrative që bashkia ofron si ato të drejtorisë të zhvillimit të territorit për aplikimet për leje ndërtimi, zhvillimi, kontolle dhe verifikime, për aplikimet për AMTP-të etj si efekt i rritjes së aplikimeve nga qytetarët, planifikohet rritje prej 3% të ardhura në vit, referuar trendit te rritur te kërkesave.

#### **Të ardhura nga Tarifa për vulosje veterinare të bagëtive të therura**

Tarifa është një detyrim fiks i cili aplikohet nga shërbimi veterinar për subjektet me aktivitet thertore, i bazuar në ligjin nr.10465, datë 29.09.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndyshuar.

Bazuar në Urdhërat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me nr. 189, datë 04.05.2018 "Për miratimin e certifikatës shëndetësore veterinare për mishin e kafshëve të llojit gjedh, të imta,derra, të therura në thertore",si dhe nr. 190,datë 04.05.2018 "Për miratimin e certifikatës shëndetësore veterinare që shoqëron lëvizjen dhe transportin e ngarkesave me lëkururë dhe produkte me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor", ku janë të miratuara modelet e certifikatave shëndetësore veterinare për mishin e kafshëve të llojit gjedh, të imta,derra, të therura në thertore si dhe modelin e certifikatës shëndetësore veterinare që shoqëron lëvizjen dhe transportin e ngarkesave me lëkurë dhe produkte me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor, ngarkohet njësia e qeverisjes vendore për prodhimin e këtyre certifikatave , të cilat shoqërohen dhe me kosto financiare.

Tarifa për vulosje mishi vendoset gjatë kryerjes nga ana e punonjësve të zyrës së veterinarisë të proçesit të kontrollit të mishit të sapotherur, me efekt çertifikimin ose jo të tij. Rritja e propozuar parashikohet të indeksojë koston e këtij shërbimi veterinar.

#### **Të ardhura nga Tarifat e licencimit te veprimtarive te transportit**

Plani i të ardhurave të parashikuara, bazohet tek trendi i aplikimeve për rinvimin e licencave për ushtrimin e veprimtarisë së subjekteve që pajisen me licencën dhe çertifikatën përkatëse për transport udhëtarësh ose mallrash, për vete ose për të tretë.

**Të ardhura nga Tarifa e parkimit për mjetet e licencuara dhe për vendparkime publike.**  
Të ardhurat e planifikuara nga tarifa e parkingut për mjetet që janë pajisur me një licencë transporti, dhe një pjesë e tyre kanë vende te caktuara me sinjalistikë te veçante rrugore si taksi, mikrobusë, autobusë etj., ku parashikohet një rritje pre 9% e kerkesave.

**Të ardhura nga Tarifa për dhënie licencë për tregtimin të naftës bruto e n/produkteve.**  
Bazuar në VKM Nr. 970, dt 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhëni e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, ky zë parashikon një shifër konstante, duke u bazuar tek trendi i aplikimeve për rinvimin e licencave për ushtrimin e veprimtarisë së subjekteve që tregtojnë karburant, të cilave u përfundon afati 5-vjeçar i licencës.

#### **Të ardhura nga Tarifat e sektorit të pyjeve dhe kullotave.**

Të ardhurat e parashikuara bazohen në trendin e aplikimeve të shërbimeve administrative që kryen sektori i pyjeve dhe kullotave.

#### **Të ardhura nga Tarifat e shërbimeve te mbrojtjes nga zjarri.**

Të ardhurat e parashikuara bazohen në nivelin e tarifave të shërbimeve që kryen struktura e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit ndaj shtetasve dhe personave, juridik e fizik, vendas e të huaj, sipas VKM, nr.607, datë 29.07.2020“Për tarifat për llojet e shërbimeve që ofrohen nga Shërbimi i Mbrotjes nga Zjarri dhe Shpëtimin” . Sipas kësaj dispozite ligjore, tarifat nuk aplikohen kur akti i ekspertimit kërcohët nga Prokuroria

#### **Të ardhura nga Tarifa për zënien e hapësirave publike.**

Parashikimi i të ardhurave është bërë duke ju referuar kërkesës në vite dhe trendit në rritje për shfrytëzimin e hapësirave publike brenda juridiksionit të Bashkisë si dhe VKM për stacionet e plazhit.

#### **Të ardhura nga Tarifat për linjat ajrore dhe nëntokësore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet).**

Parashikimi i të ardhurave është bërë duke ju referuar kapaciteteve të hapësirave brenda juridiksionit të Bashkisë. Bashkia Shkodër është duke bërë regjistrimin e infrastrukturës pasive e cila mundëson vendosjen e rrjeteve të komunikimeve elektronike, ne regjistrin

elektronik te të dhënavët në sistemin ATLAS. Ne zbatim te Ligjit nr.120/2016 “Për zhvillimin e rrjetave të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”, Vendimit nr.851 datë 07.12.2016 “Për kalimin e të dhënavët mbi shtrirjen e rrjetit të infrastrukturës inxhinierike te Bashkitë”, Ligji Nr. 9918 datë, 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” si edhe të Rregullores Nr. 26 datë 16.08.2012 “Për përbajtjen, formën dhe funksionimin e regjistrat elektronik të rrjetave publike të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë, bashkia konsiderohet si operator rrjeti, pasi ka në pronësi apo administron infrastrukturë pasive të tubacioneve, te cilat mundësojnë vendosjen e rrjetit të komunikimeve elektronike.

**Të ardhura nga tarifat për veprimtaritë në institucione të arsimit, kulturës, sportit, shërbimit social etj.**

Parashikimi i të ardhurave është bërë duke ju referuar kapacitetave të këtyre institucioneve, si dhe realizimit ndër vite, me një rritje mesatarisht prej 0.5%.


#### A.4 Te ardhura të tjera

LLOJET E TË ARDHURAVE në 000/Lekë	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
<b>TË ARDHURA TË TJERA</b>	<b>26,721</b>	<b>26,661</b>	<b>26,661</b>
Të ardhura nga kundravajtjet administrative (Gjobat)	20,000	20,000	20,000
Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të Bashkisë	2,508	3,190	3,190
Të ardhura nga sekuestrime dhe zhdëmtime	3,091	3,100	3,100
Grante nga ndihma nderkombetare me llogari ne thesar	758	0	0
Të ardhura nga shitja e mallrave dhe e sherbimeve	0	0	0
Shitia e aseteve fikse të prekshme / paprekshme	0	0	0
Të ardhura nga privatizimi	0	0	0
Të ardhura te tjera si agjent tatimor për taksën e pulles	364	371	371
Të ardhura nga garanci financiare	0	0	0
Të ardhura nga donacione/sponsorizime	0	0	0

Grante nga ndihma nderkombetare me llogari jashtë thesari	10,815		
---	--------	--	--

Të ardhurat e tjera zënë 3% të totalit të të ardhurave të veta të Bashkisë Shkodër.

Peshën më të madhe në kategorinë e të ardhurave të tjera e zënë të ardhurat nga kundravajtjet administrative (Gjobat) me 75 % të totalit të të ardhurave të tjera, duke vijuar me Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të Bashkisë 11%, Të ardhura nga sekuestrime dhe zhdëmtime me 10%, Grante nga ndihma nderkombetare me skemë të plotë thesari, ose të pjesshme thesari 3%, të ardhura te tjera 1%..



### **Te ardhurat nga kundravajtje administrative/gjobat**

Gjobat bazohen në ligjin Nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”:

